



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 98, datë 21.06.2019

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARES
REZARTA (ALIU) PAJA NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË
PARË DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimin nr. 87, datë 17.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtares Rezarta (Aliu) Paja me shkresën nr. 3284, datë 18.06.2019, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtares Rezarta (Aliu) Paja, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares Rezarta (Aliu) Paja, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet si dhe Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR